

5.9 NJOFTIMI I PËRDORUESVE TË SISTEMIT

Në programin COBISS3 mund të lexohen njoftimet, të cilat përgatiten në IZUM dhe kanë të bëjnë me funksionimin e sistemit COBISS (p.sh. instalimi i versionit të ri të programit, ndërprerjet e paralajmëruara dhe të paparalajmëruara të punës etj.).

Kur IZUM-i dërgon një njoftim të ri, të gjithë përdoruesve që ndodhen brenda programit COBISS3, brenda një ore u hapet dritarja **Njoftimet COBISS**, në të cilën mund të lexojnë njoftimin e ri dhe të gjitha njoftimet e mëhershme, të cilave ende nuk u ka skaduar vlefshmëria.

Nëse në kohën e publikimit të njoftimit të ri nuk keni qenë brenda programit COBISS3, dritarja **Njoftimet COBISS** hapet menjëher pas hyrjes së radhës.

Procedura


1. Përzgjidhni metodën **Sistemi / Njoftimet / Shfaq njoftimet COBISS**.

Hapet dritarja **Njoftimet COBISS**. Në pjesën e dritares me emrin "Lista e njoftimeve COBISS" shfaqet lista e njoftimeve të publikuara, të cilat janë ende të vlefshme. Lista e njoftimeve është e rregulluar sipas datës së publikimit, kështu që në krye të listës ndodhet njoftimi i publikuar së fundmi.

Njoftimet që nuk janë lexuar ende kanë ngjyrë të gjerbërt, ndërsa njoftimet e lexuara ngjyrë të zezë.

2. Përzgjidhni njoftimin që dëshironi ta lexoni dhe klikoni butonin **Hap**.
Hapet dritarja **Njoftimi COBISS**, në të cilën shfaqet përmbajtja e njoftimit.
3. Për mbylljen e dritares me përmbajtjen e njoftimit klikoni butonin **Në rregull**.
4. Për mbylljen e dritares me listën e njoftimeve COBISS klikoni butonin **Mbyll**.

Mundësitë...

Për njoftimin nga programi COBISS3 ju paralajmëron Desktop Alert dhe ikona COBISS3, që shfaqet në shiritin e detyrave.